



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 janar 2018
Nr. ref.: RK 1180/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI95/17

Parashtrues

Myrteza Dyla

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, PML. nr. 152/2016, të 13 shtatorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Myrteza Dyla nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 152/2016, të 13 shtatorit 2016, të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se e ka pranuar më 5 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 152/2016, të 13 shtatorit 2016, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe nenin 53 [Interpretimin i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), duke kërkuar që kërkesa e tij të trajtohet së bashku me kërkesën me numër KI70/16.
6. Fillimisht kërkesa e parashtruesit të kërkesës është trajtuar si pjesë përbërëse e lëndës KI70/16.
7. Më 18 tetor 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqaroj lidhjen e kërkesës së tij me kërkesën me nr. KI70/16, dhe të dorëzoj në Gjykatë formularin e kërkesës, si dhe të kompletojë kërkesën e tij me dokumentacion relevant, gjegjësisht vendimet e gjykatave të rregullta.
8. Më 1 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës si dhe vendimet e gjykatave të rregullta.
9. Edhe përkundër kërkesës së Gjykatës, parashtruesi nuk sqaroj pretendimin e tij për lidhjen në mes të kërkesës së tij me kërkesën me numër KI70/16.
10. Më 16 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës, për shkak të mungesës së lidhshmërisë në mes të kërkesës së tanishme me kërkesën me numër KI70/16, urdhëroi regjistrimin e kësaj kërkesë si kërkesë të veçantë, me numër KI95/17.

11. Më 22 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
12. Më 28 gusht 2017, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës së tij me numër KI95/17. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës.
13. Më 7 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 7 mars 2011, Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, ngriti Aktakuzën PP/I nr. 230/2008, kundër parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *“shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit”* nga neni 339 para 1 lidhur me para 3, lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
15. Më 29 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktgjykimin PKR. nr. 251/11, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale *“keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 para 1 të KPRK-së”*, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se parashtruesi i kërkesës në afat prej tre (3) vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kundër Aktgjykimit PKR. nr. 251/11, të 29 dhjetorit 2015, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
17. Më 4 maj 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 142/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin PKR. nr. 251/11, të 29 dhjetorit 2015, të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Në arsyetim të Aktgjykimit theksohet: *“Aktgjykimi i kundërshtuar është konkret dhe i qartë, nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e paraqitura në aktgjykimin e kundërshtuar [...] Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se aktakuza është ngritur pas tri viteve prej kur janë kryer hetimet, në këtë çështje penale vlen dispozitat e Kodit të vjetër të procedurës penale, ku prokuroria nuk ka pasur afat decidiv për ngritjen e aktakuzës [...]”*.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër dy vendimeve ë instancave më të ulëta, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të Ligjit Penal.

19. Më 27 qershor 2016, Prokurori i Shtetit të Kosovës, përmes Parashtrësës KMLP. II. nr. 111/2016, paraqiti kundërshtimin duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.
20. Më 13 shtator 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin PML. nr. 152/2016, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj dha përgjigje të detajuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 53 [Interpretimin i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], të KEDNJ-së dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës], të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“procedura hetimore ka filluar me datën 5.03.2008 e aktakuza është ngritur me dt.07.03.2011, dmth. AKTAKUZA ËSHTË NGRITUR PAS TRI VITESH. Janë tejkaluar afatet strikte ligjore të përcaktuara me nenin 225, par 1 të Kodit të Procedurës Penale i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës [...]”*.
23. Parashtruesi, duke iu referuar disa aktgjykimeve të gjykatave të rregullta të cilat nuk i ka sjellë në Gjykatë, pretendon se *“është shkelur parimi ne bis in idem nga Gjykata e shkallës së parë e cila këto prova i ka injoruar fare”*.
24. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij duhet trajtuar si çështje e njëjtë me kërkesën KI70/16, ku parashtruesi i kërkesës është personi F. K., dhe ku kërkohet vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 185/2015, të 28 dhjetorit. 2015.
25. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë Aktgjykimin PML. nr. 152/2016, të 13 shtatorit 2016, të Gjykatës Supreme, Aktgjykimin PAKR. nr. 142/2016, të 4 majit 2016, të Gjykatës së Apelit, si dhe Aktgjykimin PKR.nr.251/11, të 29 dhjetorit 2015, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

29. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b), të Rregullores së punës i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”

30. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.
31. Gjykata sjellë në vëmendje se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar parashtruesit të kërkesës i janë shkelur e drejta e lirisë dhe sigurisë, të drejtat e të akuzuarit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtja e pronës, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pretendimit themelor të parashtruesit të kërkesës se: *“Janë tejkaluar afatet strikte ligjore të përcaktuara me nenin 225, par 1. të Kodit të Procedurës Penale i cili ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës”.*
33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës të njëjtat pretendime i ka parashtruar edhe në Gjykatën Supreme dhe në gjykatat e shkallëve më të ulëta.
34. Sa i përket kësaj, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e mbështetë kërkesën e tij mbi pretendimet për interpretimin e gabuar të neneve të Kodit të

Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), të bërë nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallëve më të ulëta.

35. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore e cila vë në pah se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria), (Shih rastet e Gjykatës, KI53/15, Parashtrues: *Heset Neziri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2015, paragrafi 38 dhe KI112/15, parashtrues: *Feride Bulliqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 majit 2016, paragrafi 41).
36. Gjykata rikujton edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) e cila, *inter alia*, ka theksuar: “[...] Gjykata përsërit se juridiksioni i saj për të verifikuar se ligji i brendshëm është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte është i kufizuar dhe se nuk është funksioni i saj të zërë vendin e gjykatave vendore, roli i saj është të sigurojë që vendimet e këtyre gjykatave nuk janë të mangëta nga arbitrariteti ose qartazi të paarsyeshme” (*Anheuser-Busch Inc. v. Portugal*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83, shih po ashtu *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Bochan kundër Ukrainës* [DHM], kërkesa nr. 22251/08, Aktgjykim i 5 shkurtit 2015).
37. Gjykata thekson se është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
38. Është kryesisht roli i gjykatave të rregullta që të merren me çështjen e interpretimit të ligjit, përderisa roli i Gjykatës Kushtetuese është që të verifikojë nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në pajtim me Kushtetutën (shih në mënyrë analoge rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolono the të tjerët kundër Spanjës*, kërkesat nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 and 41509/98, Aktgjykimi i 25 janarit 2000, paragrafët 33-39).
39. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Bochan kundër Ukrainës* [DHM], kërkesa nr. 22251/08, Aktgjykim i 5 shkurtit 2015, paragrafi 61).
40. Megjithatë, në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë që ka arbitraritet në interpretimet e dhëna nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, Gjykata konsideron se arsyetimi i vendimeve të gjykatave të rregullta, për sa i përket pretendimeve të parashtruesit, është i qartë dhe i arsyetuar mjaftueshëm.

41. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. Nr. 152/2016, i 13 shtatorit 2016, adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmendura, duke konkluduar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.142/2016, i 4 majit 2016, nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të Ligjit Penal. Në këtë Aktgjykim, ndër të tjera, theksohet se *“sipas dispozitave të procedurës penale të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale-neni 225 par 1. të KPPK –së , hetimet duhet të përfundojnë në afatin prej 6 muajsh, ndërsa nga shkresat e çështjes nuk shihet se ka pasur ndonjë shkresë nga përfaqësuesi i akuzës për zgjatjen e hetimeve ndërsa akuza është ngritur më 7.03.2011 e që nga kjo rrjedh se bëhet fjalë për shkelje të kësaj dispozite të procedurës penale e cila është e karakterit relative, që nuk ka ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësorë për faktin se dispozita e nenit 224 në mënyrë taksative parasheh rastet e pushimit të hetimeve ndërsa dispozita e nenit 223 në mënyrë taksative parasheh rastet kur hetimi pezullohet kurse në asnjë dispozitë ligjore nuk theksohet se me kalimin e afatit të theksuar hetimet duhet të pushojnë[...] Përkitazi me shkeljet e Ligjit Penal, për të cilat mund të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë janë paraparë me dispozitën e nenit 385 të KPPK-së, e cila dispozitë në mënyrë taksative parasheh rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është i përfshirë me këto shkelje, ndërsa në kërkesë nuk bëhet fjalë për asnjë shkelje konform kësaj dispozite ligjore”.*
42. Për më tepër në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.142/2016, të 4 majit 2016 është potencuar fakti se në rastin konkret vlejnë dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, ku prokuroria nuk ka pasur afat decidiv për ngritjen e aktakuzës dhe në asnjë dispozitë ligjore nuk theksohet se me kalimin e afatit, hetimet duhet të pushojnë.
43. Së këndejmi, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimeve të gabuar të KPPK-së. Rrjedhimisht, asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtuesi i kërkesës (Shih, rasti KI63/16, parashtues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, para. 44. dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtues të kërkesës *Arben Gjukaq, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, para. 62.)
44. Për sa i përket pretendimit të parashtuesit të kërkesës se gjykata e shkallës ë parë ka shkelur parimin *“ne bis in dem”*, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur prova dhe argumente bindëse në mbështetje të pretendimit të tij.
45. Gjykata vë në dukje se vetëm përmendja e neneve apo parimeve përkatëse të Kushtetutës, me pretendimin se ato janë shkelur, pa dhënë shpjegime të mëtejme se si erdhi deri te këto shkelje, nuk mjafton për të ngritur një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih Rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14,

Abdullah Bajqinca, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).

46. Ndërsa përkitazi me pretendimin e parashtruesit për lidhshmërinë e kërkesës së tij me kërkesën KI70/16, Gjkata përsëritë se, përkundër kërkesës së saj, parashtruesi nuk ka qartësuar fare këtë pretendim, përkatësisht nuk ka ofruar asnjë argument që do dëshmonte ekzistimin e ndërlidhjes në mes të dy kërkesave në fjalë. Rrjedhimisht, Gjkata nuk e konsideron nevojshme që të trajtojë me tej këtë pretendim të parashtruesit.
47. Si përfundim, Gjkata rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.
48. Rrjedhimisht, Gjkata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës.
49. Prandaj, kërkesa, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 7 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi